REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 294, Datë 20.10.2026

MBI

FILLIMIN E PROCEDURËS ADMINISTRATIVE LIDHUR ME KËRKESËN E SHOQËRISË "E VENTO SRL ALBANIA" SH.P.K. PËR MODIFIKIMIN E LICENCËS NË VEPRIMTARINË E NDËRTIMIT, INSTALIMIT DHE SHFRYTËZIMIT TË CENTRALIT EOLIK

Në mbështetje të neneve 16 dhe 136, pika 2, të ligjit nr. 59/2026 *"Për sektorin e energjisë elektrike"*; neneve 10, pikat 1 dhe 3, dhe 15 të *Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike*, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar; si dhe neneve 15 dhe 19, pika 1, gërma "a" të *Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s*, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2026; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 20.10.2026, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 2990/1 prot., datë 19.10.2026, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës *"Mbi kërkesën e shoqërisë "E VENTO srl ALBANIA" sh.p.k. për modifikimin e licencës në veprimtarinë e ndërtimit, instalimit dhe shfrytëzimit të centralit eolik"***,**

Konstatoi se:

1. Të dhëna për shoqërinë

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 84, datë 17.07.2008, i ndryshuar, ka vendosur të licencojë shoqërinë "E-Vento s.r.l Albania" sh.p.k. në aktivitetin e ndërtimit, instalimit dhe shfrytëzimit të centraleve elektrike me erë si dhe prodhimin e energjisë elektrike nga parku eolik Markat dhe Livadhja (23 njësi x 2 MW për njësi, me kapacitet total 46 MW), dhe nga parku eolik Lukovë (13 njësi x 2 MW për njësi, me kapacitet total 26 MW).

- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 2990, datë 07.10.2026, shoqëria ka depozituar në ERE kërkesën për modifikimin e licencës së saj nr. 60, seria NPM08P, duke përqëndruar të gjithë kapacitetin e centralit në një fushë të vetme eolike, atë të njësisë administrative Markat, Bashkia Konispol, në vend të tre fushave të parashikuara fillimisht, dhe në zëvendësimin e njësive gjeneruese nga 36 turbina me fuqi njësi 2 MW, në 9 turbina me fuqi njësi 8 MW. Kapaciteti total i instaluar prej 72 MW mbetet i pandryshuar.
- Nga shqyrtimi paraprak i dosjes ka rezultuar se shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit, sipas përcaktimeve të Aneksit A të rregullores.

- Modifikimi konsiston në pozicionimin e projekti me kapacitet 72 MW në një fushë të vetme eolike, atë të Njësisë Administrative Markat, Bashkia Konispol; zëvendësimin e njësive gjeneruese nga 36 turbina me fuqi njësi 2 MW, në 9 turbina me fuqi njësi 8 MW, pa ndryshuar kapacitetin total të instaluar të centralit prej 72 MW; si dhe ndryshimin e afateve për ndërtimin dhe vënien në punë të centralit.

- **Përputhshmëria e Aplikimit me Rregulloren**

- Në përputhje me nenin 15, pika 4 e rregullores, aplikuesi ka dorëzuar dokumentacionin e kërkuar për modifikimin e licencës sipas germave (b dhe c).

- Nga shqyrtimi i aplikimit, rezulton se shoqëria ka kërkuar ndryshimin e të dhënave në Aneksin A dhe C të licencës nr. 60, seria NPM082. Nga ana tjetër, në rrethanat e ndryshimit të projektit eolik, vlerësohet që t'i kërkohet shoqërisë informacioni/dokumentacioni përkatës i parashikuar në Aneksin B të licencës, tek i cili përcaktohet "Afati kohor për ndërtimin dhe instalimin e centralit", e konkretisht vendosen të dhëna për "*Fazat e ndërtimit të centralit*", "*Grafiku i parashikuar i punimeve*" dhe "*Data e menduar për vënien në punë*", si e tillë vlerësohet procedura e modifikimit të fillojë përkatësisht për Anekset A, B dhe C.

- Në referencë të përcaktimeve të nenit 15, pika 4, gëma "a", të Rregullores, *shoqëria duhet të depozitojë Formatin e Shtojcës 1 të plotësuar*.

- Në referencë të përcaktimeve të nenit 15, pika 4, gëma "e", të Rregullores, shoqëria ka njoftuar ERE-n se ka bërë aplikimin përkatës për pajisje me leje mjedisore, duke bashkëngjitur dhe një kopje të formularit të aplikimit, nga i cili nuk arrihet të identifikohet data e aplikimit.

  Për sa kërkuar nga kjo pikë e rregullores dhe për të marrë miratimin për modifikimin e licencës, shoqëria duhet të depozitojë në ERE lejen apo deklaratën përkatëse mjedisore të miratuar për projektin e rishikuar, brenda afatit të përcaktuar nga rregullorja e licencimit për këtë procedurë.

- Në referencë të përcaktimeve të nenit 15, pika 4, gëma "g", të Rregullores, shoqëria ka depozituar në ERE shkresën e OST sh.a. nr. 5139/4 prot., datë 25.08.2026, "Oferta e lidhjes me rrjetin e transmetimit Parkun Eolik MARKAT, me fuqi të instaluar 72 MW, Bashkia Konispol", ku përcaktohet se OST sha ka kryer vlerësimin e mundësisë së lidhjes së parkut eolik Markat me fuqi të instaluar 72 MW me rrjetin e transmetimit dhe miraton në parim lidhjen e tij me rrjetin 110 kV të transmetimit.

  Në referencë të përcaktimeve specifike të kësaj pike të rregullores dhe për të operuar apo ushtruar veprimtarinë e licencuar, shoqëria duhet të depozitojë në ERE marrëveshjen përfundimtare të lidhjes të nënshkruar me OST sh.a., ndaj do t'i kërkohet depozitimi i saj.

- Në lidhje me fillimin e procedurës për modifikimin e licencës së shoqërisë sipas kërkesës së saj, vlerësohet që të njoftohet dhe Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM) dhe "Operatori i Sistemit të Transmetimit" (OST) sh.a.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të fillojë procedurën administrative për modifikimin e Anekseve A, B dhe C të licencës nr. 60, seria NPM08P, të shoqërisë "E VENTO SRL ALBANIA" sh.p.k., dhënë me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 84, datë 17.07.2008, i ndryshuar, për veprimtarinë e ndërtimit, instalimit dhe shfrytëzimit të centralit eolik.
2. Shoqëria "E VENTO srl ALBANIA" sh.p.k. duhet të depozitojë në ERE dokumentacionin dhe sqarimet përkatëse të kërkuara gjatë shqyrtimit të aplikimit, në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi dhe të *"Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike*".
3. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës, të njoftojë shoqërinë "E VENTO srl ALBANIA" sh.p.k., Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, Agjencinë Kombëtare të Mjedisit dhe shoqërinë "Operatori i Sistemit të Transmetimit" (OST) sh.a., për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni të vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare. Paraqitja e ankimit nuk pezullon vlefshmërinë e vendimit, përveçse kur gjykata vendos ndryshe në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI